



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 45
Prishtinë, më 18 maj 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Suzana Novoberdaliu, Eqrem Kryeziu, Lulzim Zeneli, Melihate Termkolli dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të Komisionit.

Munguan: Zafir Berisha dhe Zylfi Merxha

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Nuredin Ibishi dhe Afrim Hoti.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28. 04. 2010,
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 28. 04. 2010

Procesverbali i 28. 04. 2010 u miratuan pa vërejtje.

3. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Për Raportin e progresit të Komisionit Evropian, përgjegjës ka qenë Shkumbin Demailaj. Meqë ky detyrim nuk është kryer nga deputeti Demailaj, përgjegjësinë për këtë do ta marr unë, si kryetar i Komisionit. Duhet të koordinohen punët sa më shpejt, sepse koha është shumë e shkurtër.

Desha t’ju njoftoj për vizitën në Ministrinë e Punëve të Brendshme që do të bëhet sot. I kam ftuar të gjithë deputetët të marrin pjesë. Përparësitë e ministrit të kësaj Ministrie tani janë më të qarta. Pritet të ketë stabilizim të infrastrukturës në Polici – në njësitet e saj.

Edhe ndërrimet e deputetëve po ndikojnë në punën e Komisionit. Zafir Berisha është zëvendësuar me Basri Musmuratin, që sot nuk është i pranishëm. Do të zëvendësohet edhe Melihate Termkolli me një deputet tjetër. Për shkak të këtyre ndërrimeve ka mungesë në Komision.

Shkumbin Demaliaj – Unë kam qenë i caktuar për Raportin e progresit, por për shkak të disa angazhimeve që i kam pasur, nuk kam mundur të jem i pranishëm për këtë çështje. Duke pasur parasysh se kjo është më shumë punë e stafit, nuk e kam parë të arsyeshme që për këtë përgjegjësi t’i bartet dikujt tjetër. Nuk do të vij në takim me ministrin, sepse është takim formal, kurse takimi do të duhej të bëhej për ndonjë progres të arritur.

Melihate Termkolli – Unë pajtohem me Shkumbinin sa i përket vizitës në MPB. Ne e kemi rolin tonë si Kuvend, por edhe Qeveria e ka rolin e vet. Mendoj se kjo çështje nuk i përket deputetëve dhe këtij Komisioni. Nuk e shoh të arsyeshme të bëhet një veprim i tillë. Ministri është dashur të jetë i pranishëm këtu. Besoj se ka mjaft tema për t’i diskutuar dhe ne do t’i parashtronim çështjet që na preokupojnë.

Lulzim Zeneli – Agjenda e Komisionit do të ishte më e ngjeshur nëse do të diskutonim për pikat e Raportit të progresit. Kjo ndërlidhet me punën e ekzekutivit - sa i ka kryer këto detyrime. Mendoj se duhet të zhvillohet takimi në MPB-në. Ministri i ri ka dhënë fjalë shumë të mëdha. Ndër to janë zbardhja e Dhomës së Dëshmive dhe trajtimi i ngjarjeve të fundit. Jam ithtar i asaj që raportet në komision parlamentar dhe në ekzekutiv të jenë më të rregullta, sepse deri tani nuk kanë qenë të tilla.

Kemi biseduar shumë për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Policisë, por po e shoh se ka ngecur. Propozoj të futet prapë në agjendë, sepse ne si komision e kemi për detyrë ta mbikëqyrim punën e ekzekutivit.

Kryetari i Komisionit – Kjo ka ndodhur për shkak të ndërrimit të shpeshtë të deputetëve nëpër komisione. Mendoj se puna në Komision do të vazhdojë të zhvillohet me dinamikë, si më parë.

Pasi nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E hartoi:

Njësia mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Rrustem Mustafa